

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2001/24
1 tetor 2001

RREGULLORJA NR. 2001/24

**NDRYSHIM I RREGULLORES NR. 1999/20 MBI AUTORITETIN
BANKAR DHE TË PAGESAVE TË KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1, të ndryshuar, të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/20 të datës 15 nëntor 1999 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës,

Me qëllim të avancimit të kompetencave të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës lidhur me rregullimin, licencimin dhe kontrollimin e institucioneve financiare në Kosovë,

Me anë të kësaj ndryshon Rregulloren nr. 1999/20 të UNMIK-ut.

Rrjedhimisht, Rregullorja do të ketë formulimin e mëposhtëm që nga data e hyrjes së saj në fuqi:

RREGULLORJA NR. 1999/20

MBI AUTORITETIN BANKAR DHE TË PAGESAVE TË KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të forcimit të ekonomisë së Kosovës me anë të institucioneve financiare e sistemeve të shëndosha dhe efikase përmes themelimit të Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës,

Me anë të kësaj Rregulloreje shpall sa vijon:

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Statusi i Autoritetit Bankar dhe i Pagesave të Kosovës

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave i Kosovës (më poshtë i quajtur “BPK”) është një person i veçantë publik dhe juridik.

Neni 2

Definimi

Termat që do të përdoren në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

“Bankë” do të thotë një person juridik i angazhuar në punën e pranimit të depozitave në Kosovë dhe përdorimin e fondeve të tilla në mënyrë të plotë ose të pjesërishtme për dhënien e kredive ose investimeve për llogari dhe në rrezik të personave që e bëjnë atë biznes;

“Kredi” do të thotë çdo zotim direkt ose indirekt për dhënien e një shume parash në këmbim për të drejtën e ripagimit të shumës së paguar dhe të pashlyer dhe për pagimin e kamatës dhe pagesave të tjera për atës shumë

parash, çdo vazhdim i afatit të paraparë për pagesën e një borxhi, çdo garanci për pagesën e borxhit dhe çdo zotim për fitimin e të drejtës për pagimin e një shume parash; termi “kredit” nuk përfshinë depozitat bankare dhe blerjen e letrave me vlerë në tregun sekondar;

”Letra me vlerë” do të thotë çdo instrument këmbyes për pagim të borxhit dhe çdo lloj instrumenti tjetër ekvivalent me instrumentin mbi borxhin në formë të garantuar ose të hyrave në llogari;

“Institucion financiar” do të thotë një organizatë siç është banka, kompania e sigurimit, personi ndërmjetësues i sigurimit ose ndonjë person tjetër që ofron një ose më shumë shërbime financiare vijuese: marrjen e depozitave, ofrimin e shërbimeve të sigurimit për të siguruarit, zgjatjen e e kredisë, shlyerjen e borxhit, marrjen me shitblerjen e aksioneve ose shpërndarjen e letrave me vlerë, punën si menaxher i kompanisë investuese ose si këshilltar investimi, ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë shërbimet financiare për dhënien me qira të pajisjeve, blerjen e borxheve nga personat tjerë, shërbimet mikrofinanciare apo këmbimi i jashtëm valutës, ose shërbimet e tjera financiare informative, këshilluese dhe bankare;

“Direktiva” do të thotë rekomandime jodetyruese ose deklarata të politikës së punës të lëshuara nga BPK për informimin e institucioneve financiare dhe palëve të tjera të interesuara për punën e BPK-së;

“Kompani sigurimi” do të thotë person juridik i angazhuar në dhënien e shërbimeve të sigurimeve për të siguruarit;

“Ndërmjetësues sigurimi” do të thotë agjent i sigurimeve, nënagjent ose ndërmjetësues, qoftë i themeluar si korporatë ose jokorporatë;

“Standarde ndërkombëtare të kontabilitetit” do të thotë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të nxjerra nga Komiteti Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit;

“Urdhër” do të thotë një direktivë detyruese e nxjerrë nga BPK-ja për zbatimin e kësaj Rregulloreje;

“Pagesa të arsyeshme” do të thotë pagesat që mbulojnë shpenzimet direkte ose indirekte të BPK-së të cilat bënka i bën për kryerjen e shërbimit ose shërbimeve për të cilat paguhet një taksë dhe

“Rregull” do të thotë urdhëresë e detyrueshme e nxjerrë nga BPK-ja për zbatimin e kësaj Rregulloreje për të gjitha institucionet financiare.

Neni 3
Të drejtat e BPK-së

3.1 BPK-ja ka të drejtë:

(a) Të lidhë kontrata dhe

(b) Të blejë, të mbajë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme për qëllime të biznesit në përputhje me këtë Rregullore dhe me legjislacionin në fuqi.

3.2 BPK-ja mund të shfrytëzojë dhe administrojë, në emër të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK-ut”), pronën e Bankës Popullore të Kosovës me seli në rrugën “Mareshali Tito” në Prishtinë (tani e njohur si rruga “Nëna Terezë”), si dhe të Shërbimit për sistemin e pagesave të Kosovës me seli në rrugën “Lenini” në Prishtinë.

Neni 4
Kompetencat e përgjithshme

4.1 BPK-ja i ushtron të gjitha kompetencat e dhëna me këtë Rregullore dhe me legjislacionin në fuqi si dhe kompetencat tjera të domosdoshme për zbatimin e tyre ligjor.

4.2 Sipas kësaj Rregulloreje, BPK-ja gëzon autonomi operative dhe administrative, përveç rasteve të parapara në të. Askujt nuk i lejohet të ndikojë mbi ndonjë anëtar të Këshillit Drejtues të BPK-së ose në ndonjë punonjës tjetër në kryerjen e punëve të tij apo të saj apo të ndërhyjë në punët e BPK-së.

Neni 5
Qëllimet kryesore

Qëllimet kryesore të BPK-së janë:

(a) të nxit një sistem efikas dhe të sigurt për pagesat e brendshme dhe

(b) të nxit likuiditetin, aftësinë paguese dhe funksionimin efikas të një sistemi financiar të bazuar në një tregu stabil, duke përfshirë rregullimin e bankave, kompanitë e sigurimit dhe institucionet e tjera financiare.

Neni 6
Kompetencat e veçanta

BPK-ja i ka këto kompetenca të veçanta:

(a) T'i rekomandojë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm këshilla të përgjithshme të politikës së punës në fushat e përgjegjësisë së saj, nën udhëheqjen e zëvendësit të Përfaqësuesit Special për Rindërtim dhe Zhvillim Ekonomik;

(b) Të formulojë dhe të zbatojë masat për rregullimin dhe mbikëqyrjen e pagesave dhe sistemeve për rregullimin e transaksioneve me valutë të vendit dhe të huaj në Kosovë;

(c) Të ketë dhe të zbatojë një ose më shumë sisteme pagesash;

(ç) Të veprojë si bankë për Autoritetin Qendror Fiskal dhe, me kërkesën e tij, t'i jep këshilla financiare;

(d) Të veprojë si agjent fiskal i Autoritetit Qendror Fiskal;

(dh) Të mbajë depozita në valutë të huaj të bankave të Autoritetit Qendror Fiskal dhe të subjekteve të tjera;

(e) Të sigurojë para të mjaftueshme në banknota dhe monedha për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme;

(ë) Të sigurojë një vend për ruajtjen e sigurt të parave dhe letrave me vlerë;

(f) T'i licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare;

(g) T'i mbikëqyrë dhe kontrollojë dilerët e këmbimit të valutave të huaja dhe

(gj) Të kryejë rregullisht analiza ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, t'i publikojë rezultatet dhe t'ia paraqesë propozimet dhe masat Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në bazë të atyre analizave.

Neni 7

Bashkëpunimi me Administratën e Përkohshme të KB-së në

Kosovë

7.1 BPK-ja bashkëpunon me UNMIK-un, Administratën e Përkohshme të KB në Kosovë dhe me organizatat e saj me qëllim të arritjes së objektivave të saj.

7.2 Herë pas here, me kërkesën e Autoritetit Qendror Fiskal dhe organizatave të tjera të Administratës të Përkohshme të KB-së, BPK-ja jep informata të përgjithshme sa i përket pagesave, çështjeve bankare e financiare dhe kohë pas kohe, sipas kërkesës së BPK-së, ata i ofrojnë informata sipas kërkesës së BPK-së për çështjet makroekonomike dhe financiare.

Neni 8 Bashkëpunimi teknik

8.1 BPK-ja mund të marrë pjesë në mbledhjet e këshillave dhe organizatave ndërkombëtare që kanë të bëjnë me aspektet teknike të sistemit të pagesave, mbikëqyrjen e institucioneve financiare dhe çështjeve të tjera që janë në fushëveprimin e saj.

8.2 BPK-ja mund t'i ofrojë shërbime bankare dhe të pagesave në dobi të qeverive të vendeve të huaja, bankave të huaja, autoriteteve të huaja monetare, organizatave publike ndërkombëtare dhe institucioneve të tjera.

Neni 9 Informimi publik

BPK-ja e informon rregullisht dhe me kohë opinionin publik dhe Autoritetin Qendror Fiskal për analizat e saj të zhvillimit të tregut makroekonomik dhe financiar si dhe për të dhënat e ngjashme statistikore.

Neni 10 Zyrat e BPK-së

Zyra kryesore e BPK-së do të jetë në Prishtinë. Sipas nevojës dhe vlerësimit të saj të lirë, BPK-ja mund të hapë filiala, zyra koordinimi e përfaqësimi në Kosovë dhe jashtë saj.

Neni 11 Llogaritë

11. 1 BPK-ja mund të hapë llogari në librat e saj vetëm në emër të Autoritetit Qendror Fiskal, të subjekteve të tjera të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të institucioneve financiare që veprojnë ligjërisht në Kosovë, të bankave të huaja, të institucioneve

financiare ndërkombtare publike dhe të organizatave donatore. BPK-ja nuk mund të hapë llogari në emër të personave fizikë dhe të ndërmarrjeve.

11.2 Të gjitha detyrimet e depozituara në llogarinë e BPK-së duhet të kenë pasuri financiare gjegjëse siç është përcaktuar në nenin 48 të kësaj Rregulloreje.

DISPOZITAT FINANCIARE

Neni 12

Kapitali

12.1 Kapitali i autorizuar i BPK-së është 5 milionë DM. Ndërkaq, kapitali i llogarive të rezervave të përgjithshme është i barabartë me masën prej 5 për qind të shumës së përgjithshme të bilancit të kredisë të të gjitha llogarive që mbahen në librat e BPK-së nga bartësit e llogarive të paraqitura në bilancin e BPK-së në fund të çdo viti financiar. Kapitali mund të zmadhohet në një shumë më të madhe të përcaktuar nga BPK-ja dhe të miratohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Kapitali i BPK-së nuk i nënshtrohet hipotekës apo ndonjë pengese tjetër.

12.2 Kurrfarë zvogëlimi i Kapitalit të BPK-së nuk mund të bëhet përveç me anë të shpalljes me ndonjë rregulloreje nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

12.3 Kurdoherë që:

(a) Vlera e aktivitetit të BPK-së e paraqitur në faturën e bilancit mujor të saj bie nën shumën e detyrimeve dhe të kapitalit të paprekur të autorizuar, ose

(b) Fitimi i pastër i BPK-së për një vit financiar është i pamjaftueshëm për zmadhimin e kapitalit dhe llogaritë e përgjithshme rezervë të BPK-së në një nivel të barabartë me pesë për qind të shumës së përgjithshme të bilanceve të kredisë të të gjitha llogarive të klientëve që mbahen në librat e BPK-së nga mbajtësit e llogarive të pasqyruara në bilancin e BPK-së në fund të atij viti financiar, Autoriteti Qendror Fiskal një muaj pas publikimit të bilancit duhet t'i bëjë të gjitha përpjeket në kuadër të burimeve që i ka në dispozicion për t'i kontribuar maksimalisht BPK-së për sigurimin e kapitalit në shumën apo shumatat që nevojiten për mbulimin e deficitit.

Neni 13

Përcaktimi dhe akordimi i të ardhurave

13.1 Për çdo vit do të llogaritet fitimi neto apo humbja neto e BPK-së në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

13.2 Fitimi neto akordohet për çdo vit në llogarinë e rezervave të përgjithshme, derisa kapitali dhe llogaria e rezervave të përgjithshme nuk barazohen me pesë përqindëshin e shumës së përgjithshme të bilanceve kreditore të të gjitha llogarive të mbajtura në libra të BPK-së nga mbajtësit e llogarisë, të pasqyruara në bilancin e BPK-së në fund të çdo viti financiar.

13.3 Të gjitha shumat e fitimit neto do të transferohen si të hyra buxhetore në buxhetin e Autoritetit Qendror Fiskal.

13.4 Nëse do të ketë humbje neto, ajo do të mbulohet nga llogaria e rezervave të përgjithshme ose nga kapitali i paraparë për këtë destinim.

Neni 14 Buxheti vjetor

Të gjitha shpenzimet e propozuara materiale të BPK-së duhet të paraqiten në buxhetin vjetor për t'u miratuar nga Këshilli drejtues dhe ato i dorëzhen për informim Autoritetit Qendror Fiskal.

ORGANIZIMI DHE UDHËHEQJA

Neni 15 Organizimi i BPK-së

BPK-ja ka Këshillin drejtues, udhëheqjen dhe personelin.

Neni 16 Këshilli drejtues

16.1 Këshilli drejtues harton politikën e veprimtarisë së BPK-së dhe mbikëqyrë zbatimin e saj.

16.2 Personeli i BPK-së i raporton të paktën dhjetë herë në vit Këshillit drejtues për zbatimin dhe mbarëvajtjen e politikës së veprimtarisë së përcaktuar, për gjendjen e sistemit financiar, për gjendjen e parave, për kapitalin dhe tregun devizor, duke përfshirë këtu të gjitha rrethanat dhe kushtet që kanë ose që pritet të kenë efekt të ndjeshëm në udhëheqjen a veprimtarinë e BPK-së ose kryerjen e detyrave të saj në sistemin financiar apo në tregjet e sipërpërmendura.

Neni 17
Kompetencat e Këshillit drejtues

Këshilli drejtues do të ketë kompetencat vijuese:

- (a) Të përcaktojë politikën për përmbushjen e kompetencave të BPK-së të përshkruara në nenin 6 dhe të mbikëqyrë zbatimin e tyre nga udhëheqësi dhe personeli;
- (b) T'i miratojë të gjitha rregullat, urdhërat dhe udhëzimet parimore të nxjerra nga BPK-ja;
- (c) T'i aprovojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që BPK-ja ia bën Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë;
- (ç) T'i rekomandojë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për pjesëmarrjen e BPK-së në konsultimet teknike me organizatat ndërkombtare;
- (d) Të miratojë statutin e BPK-së;
- (dh) Të parcaktojë organizimin e BPK-së;
- (e) Të emërojë inspektorin e përgjithshëm të BPK-së;
- (ë) Të hapë dhe të mbyllë filialat dhe agjencitë e BPK-së;
- (f) Të përcaktojë buxhetin e BPK-së dhe kushtet për punësimin e punëtorëve, agjentëve dhe korrespondentëve të BPK-së;
- (g) Të përcaktojë detyrat e kontabilitetit të BPK-së dhe të miratojë raportet periodike dhe pasqyrat financiare të BPK-së;
- (gj) Të vendosë të marrë përsipër borxhet në shuma të konsiderueshme të BPK-së dhe për kushtet e borxheve të tilla;
- (h) Të përcaktojë shumat e përshtatshme për investimin e burimeve financiare të BPK-së;
- (i) Të miratojë ose të refuzojë kërkesat për licenca të institucioneve financiare ose regjistrimet dhe të revokojë licencat e institucioneve financiare apo regjistrimet dhe
- (j) Të miratojë organizimin e brendshëm, politikën dhe procedurat për licencim, regjistrim, mbikëqyrje dhe rregullim të institucioneve financiare.

Neni 18
Përbërja e Këshillit drejtues

18.1 Këshilli drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë që i cakton Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, e ata janë: kryetari, drejtori teknik, zëvendësdrejtori i përgjithshëm për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankës, zëvendësdrejtori teknik për sistemin e pagesave dhe tre anëtarë të tjerë (dy prej të cilëve caktohen nga Administrata e Përkohshme e KB-së në Kosovë).

18.2 Anëtarët e Këshillit drejtues duhet të kenë aftësi organizative dhe përvojë profesionale për çështjet financiare dhe bankare.

18.3 Mandati i çdo anëtari të Këshillit drejtues është gjashtë (6) vjet, me të drejtë të rizgjedhjes.

Neni 19
Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit drejtues

As appropriate, anëtarët e Këshillit marrin shpërblime të njëjta si personat që mbajnë poste ekzekutive ose joekzekutive në këshillat udhëheqëse apo mbikëqyrëse në institucionet e mëdha financiare në rajon.

Neni 20
E drejta për të qenë anëtar i Këshillit drejtues

Asnjë person nuk mund të jetë anëtarë i Këshillit drejtues nëse është i punësuar në ndonjë institucion financiar të Kosovës dhe nëse është zotërues i pesë për qind apo më shumë të pjesëmarrjes në kapitalin e një institucioni financiar.

Neni 21
Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit drejtues

21.1 Çdo anëtar i Këshilli drejtues mund të shkarkohet nga Këshilli ose nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, nëse Këshilli nuk e bën këtë në rastet ku ai apo ajo:

- (a) e humb të drejtën për të qenë anëtar i Këshillit drejtues në përputhje me nenin 20;
- (b) është denuar për një vepër penale për të cilën parashihet dënimi me burgim në pamundësinë e dënimit me gjobë;

(c) ka qenë borxhli i bankës në procedurën e falimentimit ose paaftësisë paguese;

(ç) për shkak të paaftësisë dhe sjelljeve personale jo korrekte është larguar nga ushtrimi i detyrës së anëtarit të organit përgjegjës dhe

(d) kur shumica e anëtarëve të Këshillit drejtues konstaton se anëtari është angazhuar në veprimtari të kundërligjshme dhe kur ka sjellje jokorrekte në vendin e punës.

21.1 Përveç dispozitave të nenit 21.1, çdo anëtar të Këshillit drejtues mund ta shkarkojë nga detyra e anëtarit të këshillit, vetë këshilli ose Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, në rastet kur këtë nuk e bën këshilli, sipas rekomandimit të shumicës së anëtarëve të Këshillit drejtues, në rastet kur anëtari:

(a) nuk është në gjendje ta ushtrojë funksionin e tij për shkaqe të paaftësisë trupore ose mendore që zgjat më shumë se dy muaj dhe

(b) kur ka munguar radhazi në tri mbledhjet e Këshillit drejtues, të cilat mungesa, sipas mendimit të këshillit, janë të paarsyeshme.

Neni 22 Dorëheqja

Çdo anëtar i Këshillit drejtues mund të jep dorëheqje duke ia paralajmëruar atë Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të paktën një muaj më parë.

Neni 23 Vendet e lira në Këshillin drejtues

Çdo vend i lirë në Këshillin drejtues do të plotësohet duke emëruar një anëtar të ri të Këshillit drejtues në pajtim me nenin 18.

Neni 24 Mbledhjet e Këshillit drejtues

24.1 Mbledhjet e Këshillit drejtues drejtohen nga kryetari i Këshillit drejtues, e në mungesë të tij drejtohen nga një anëtar i Këshillit drejtues.

24.2 Mbledhjet e këshillit drejtues mbahen sipas nevojave afariste të BPK-së, por jo më pak se një herë në muaj.

24.3 Mbledhjet e Këshillit drejtues thirren nga drejtori teknik; ato mund të thirren edhe me kërkesën me shkrim të ndonjë anëtari të Këshillit drejtues.

24.4 Mbledhjet e Këshillit drejtues thirren duke i informuar të gjithë anëtarët e Këshillit drejtues për kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes të paktën 5 (pesë) ditë pune para ditës së mbajtjes së mbledhjes; në rastet urgjente mbledhjet mund të thirren në afat kohor më të shkurtër.

24.5 Çdo anëtar i Këshillit drejtues ka një votë. Në rastin e ndarjes së barabartë të votave, vota e kryetarit është vendimtare.

24.6 Kuorumi i nevojshëm për kryerjen e çfarëdo pune në çdo mbledhje të Këshillit drejtues është pesë (5) anëtarë të Këshillit drejtues.

24.7 Pos në rastet kur përcaktohet ndryshe me këtë Rregullore, vendimet e Këshillit drejtues miratohen me shumicën e thjeshtë të votave të pjesëmarrësve në mbledhje. Megjithatë, statuti i BPK-së mund të parasheh mbajtjen e mbledhjeve dhe votimin me anë të telefonit dhe në rastet e jashtëzakonshme me anë të teleksit të verifikuar ose me anë të mjeteve të tjera të verifikuara elektronike të telekomunikacionit.

24.8 Mungesa e kuoromit të nevojshëm nga neni 24.6. i kësaj Rregulloreje për shkak të ndonjë vendi ose vendeve të lira në këshillin drejtues nuk zhvleftëson asnjë akt ose veprim të Këshillit drejtues.

24.9 Të gjitha veprimet e anëtarit të Këshillit drejtues të kryera në mirëbesim si anëtar i Këshillit drejtues janë të vlefshme edhe nëse më vonë zbulohen mangësi sa i përket emërimit apo kualifikimet të tij për të qenë anëtarë.

Neni 25

Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit drejtues

25.1 Procesverbalet e mbledhjeve të këshillit janë konfidenciale. Këshilli drejtues mund të vendosë t'i bëjë publike rezultatet e vendimeve të tij për çdo çështje dhe vendimet e tij lidhur me afarizmin e politikës së përgjithshme t'i publikojë menjëherë.

25.2 Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit drejtues nënshkruhet nga kryetari apo nga drejtuesi i mbledhjes dhe nga sekretari i Këshillit drejtues.

25.3 Sekretarin e Këshillit drejtues e emëron drejtori teknik nga mesi i punëtorëve me përvojë në BPK për të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Këshillit drejtues dhe për të mbajtur të gjitha dhe për të ushtruar funksione të tjera të përcaktuara me statutin e BPK-së. Sekretari nuk mund të jetë anëtar i Këshillit drejtues.

Neni 26

Zbulimi nga anëtarët e Këshillit drejtues; besnikëria

26.1 Anëtarët e Këshillit drejtues kohë pas kohe i zbulojnë Këshillit drejtues të gjitha interesat e rëndësishme financiare të cilat ata apo anëtarët e familjeve të tyre mund t'i kenë direkt apo indirekt dhe zbulimet e tilla bëhen në përputhje me udhëzimet e miratuara nga Këshilli drejtues.

26.2 Kurdoherë që një çështje ka të bëjë me një interes të till shtrohet për diskutim para Këshillit drejtues, anëtari i interesuar në fillim të diskutimit tregon interesin e tij dhe nuk merr pjesë në diskutim dhe në marrjen e vendimit për këtë çështje; megjithatë, prania e tij merret parasysh me rastin e caktimit të kuorumit;

26.3 Anëtarët e Këshillit drejtues dhe punonjësit e BPK-së kanë detyrë fiduciare ndaj BPK-së dhe klientëve të BPK-së për t'i vënë intereseat e BPK-së dhe të klientëve të saj para interesave të tyre financiar.

Neni 27

Përbërja e udhëheqjes së BPK-së

Drejtorja e e BPK-së përbëhet nga drejtori teknik, zëvendës drejtori teknik për mbikqyrjen financiare të institucionit dhe zëvendës drejtori teknik për sistemin e pagesave.

Neni 28

Shërbimet plotësuese

Ish-anëtarët e Këshillit drejtues nuk mund të ushtrorjnë punë profesionale në institucionet financiare që bëjnë biznes në Kosovë për një periudhë prej një viti menjëherë pas lagimit të tyre nga BPK-ja.

Neni 29

Drejtorja e BPK-së

29.1 Drejtori teknik ushtron detyrën e drejtorit ekzekutiv të BPK-së i ngarkuar me udhëheqjen e veprimtarisë së përditshme të BPK-së. Nëse drejtori teknik mungon nga puna ose nuk mund ta ushtrojë detyrën, atëherë në mungesë të tij zëvendësdrejtori teknik për mbikëqyrjen financiare të institucionit, ose në mungesë të tij zëvendësdrejtori teknik për sistemin e pagesave i kryen punët drejtorit ekzekutiv të BPK-së

29.2 Drejtori teknik i përgjigjet Këshillit drejtues për zbatimin e vendimeve të BPK-së, si dhe për udhëheqjen dhe kontrollin e administrimit të veprimtarisë së BPK-së.

29.3 Të gjitha autorizimet që nuk janë veçmas të rezervuara për Këshillin drejtues i ka drejtori teknik. Drejtori teknik, brenda autorizimeve të tij, ka mundësi të ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara dhe të nevojshme për administrimin dhe punët e BPK-së, duke përfshirë pa kufizime nënshkrimin e kontratave në emër të BPK-së, emërimin e punonjësve, agjentëve dhe korrespondentëve të BPK-së dhe në përgjithësi e përfaqëson BPK-në. Drejtori teknik, me lejen e Këshillit drejtues, mund t'ua jep disa nga kompetencat e tij punonjësve të tjerë të BPK-së.

29.4 Zëvendësdrejtori teknik për mbikëqyrjen financiare të institucionit i përgjigjet drejtorit teknik. Pavarësisht nga neni 17, zëvendësdrejtori teknik për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankës ka kompetenca për ndërmarrjen e masave detyruese, duke përfshirë këtu edhe dhënien e urdhërit për çdo institucion financiar për ndërmarrjen e masave plotësuese, caktimin e një administratori të përkohshëm për ndonjë institucion financiar, ose vënien e dënimeve të parapara me këtë Rregullore apo me ligjet dhe rregulloret e tjera në fuqi lidhur me licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare.

29.5 Zëvendësdrejtori teknik për sistemin e pagesave i përgjigjet drejtorit teknik.

Neni 30

Kontrollori i përgjithshëm i BPK-së

30.1 Kontrollori i përgjithshëm i BPK-së emërohet nga drejtori teknik me pëlqimin e Këshillit drejtues. Ai duhet të jetë person i kualifikuar dhe legjitim për të ushtruar detyrën në Këshillin drejtues.

30.2 Kontrollori i përgjithshëm mund të japë dorëheqje duke e paralajmëruar për këtë me shkrim drejtorin teknik dy muaj përpara. Kontrollori i përgjithshëm shkarkohet nga detyra vetëm me vendimin e përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose të Këshillit drejtues dhe largimi i tij mbështetet në një apo në më shumë arsye të përcaktuara në nenin 21 të kësaj Rregulloreje.

30.3 Detyrat e kontrollorit të përgjithshëm janë:

- (a) Vlerësimi i cilësisë së administrimit ekzistues dhe administrimit të propozuar si dhe të sistemeve të kontrollit financiar;
- (b) Testimi i funksionimit të atyre sistemeve dhe i besueshmërisë e tërësisë së informatave dhe transaksioneve të kryera;
- (c) Testimi i përshtatshmërisë së kontrollimeve për ruajtjen e pasurisë së BPK-së dhe, sipas nevojës, verifikimi i ekzistencës së pasurisë;
- (ç) Testimi i përputhshmërisë së aktiviteteve të BPK-s me ligjet, rregulloret dhe direktivat administrative, urdhërat dhe politikën drejtuese të BPK-së;
- (d) Rishikimi i përdorimit të drejtë dhe të efektshëm të burimeve të BPK-së dhe dhënia e rekomandimeve të duhura udhëheqësisë dhe
- (dh) Kryerja e shqyrtimeve të veçanta kur kërkohet nga Drejtoria me kërkesë të drejtorisë dhe mbajtja e lidhjeve me revizorët e BPK-së.

Neni 31

Personeli i BPK-së

31.1 Nëse Këshilli punëdrejtues nuk vendos ndryshe, BPK-ja është i vetmi autoritet që mund të punësojë personelin e BPK-së.

31.2 Këshilli drejtues miraton kriteret dhe kushtet e punësimit, të cilat përfshijnë dispozitat për pengimin e konflikteve të interesit.

Neni 32

Punëtorët, agjentët dhe korespondentët e BPK-së

32.1 Drejtori teknik emëron dhe shkarkon punëtorët, agjentët dhe korespondentët e BPK-së në përputhje me kriteret dhe kushtet e përgjithshme të punësimit të miratuara nga Këshilli drejtues.

32.2 Asnjë pagë, provizion, mëditje ose ndonjë shpërblim a kompensim i paguar në para nga BPK-ja nuk llogaritet në të ardhurat neto, në fitimin neto ose të ardhura e tjera të BPK-së.

Neni 33
Konflikti i interesit

33.1 Drejtoria dhe kontrollori i përgjithshëm duhet t'ia përkushtojnë të gjithë shërbimet profesionale BPK-së dhe nuk mund të kenë funksione e të jenë të punësuar diku tjetër, me apo pa pagesë, përveç si kandidatë të BPK-së dhe për punë e përpjekje edukativo-shoqërore të rastit.

33.2 Asnjë anëtar i Këshillit drejtues ose ndonjë punëtori tjetër të BPK-së nuk i lejohej të pranojë dhurata apo kredi në emër të vetin, ose në emër të ndonjë personi me të cilin ka lidhje familjare, lidhje afariste a financiare në qoftë se pranimi i tillë do të ndikonte apo do të linte përshtypjen e zvogëlimit të përkushtimit objektiv gjatë kryerjes së detyrave në BPK.

Neni 34
Sekreti

34.1 Asnjë personi i cili shërben ose ka shërbyer si anëtar i Këshillit drejtues, i personelit, stafit ose si revizor, si agjent ose korrespondent i BPK-së nuk i lejohej që në mënyrë të paautorizuar sipas kësaj Rregulloreje të përvetësojë informata, t'i zbulojë apo publikojë ato që nuk janë për publik e të cilat ai i ka marrë gjatë ushtrimit të detyrave të tij në BPK apo të përdorë informata të tilla ose të lejojë përdorimin e informatave të tilla për përfitime personale.

34.2 Pavarësisht nga neni 34.1., këta persona mund të nxjerrin informata të materialeve jopublike jashtë BPK-së në përputhje me procedurat e miratuara nga BPK vetëm në rastet:

(a) kur kjo bëhet në përputhje me pëlqimin e shprehur apo të nënkuptuar të personit me të cilin ka të bëjë informata;

(b) kur gjatë kryerjes së detyrave publike me palët, zbulon informata, duke përfshirë këtu rastet kur kjo bëhet me qëllim që të ndihmohet zbatimi i ligjit dhe i rendit publik, si dhe atëherë kur kjo bëhet me urdhrin e gjykatës apo të ndonjë personi tjetër kompetent,

(c) kur i jepen revizorit të BPK-së;

(ç) kur i jepen organeve mbikëqyrëse të institucioneve financiare dhe personelit të institucioneve financiare publike ndërkombëtare për kryerjen e detyrave të tyre dhe

(d) kur interesi i vetë BPK-së në procedura ligjore kërkon zbulimin e informatave.

RAPORTET ME SUBJEKTET E ADMINISTRATËS SË PËRKOHSHME TË KB-së NË KOSOVË

Neni 35

Agjenti bankar, financiar, këshilldhënës dhe fiskal

35.1 BPK-ja vepron si bankar, si këshilldhënës dhe si agjent i Organit Qendror Fiskal dhe i subjekteve të tjera të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me kusht që asnjë transaksion i kryer nga BPK-ja të mos jetë në shërbim të dhënies së kredisë ose në llogari të ndonjë organi publik apo të ndonjë personi tjetër fizik dhe juridik.

35.2 BPK-ja ka për detyrë t'i japë këshilla Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, rreth çështjeve të rëndësishme financiare që kanë të bëjnë me objektivat e BPK-së, ose që janë në kompetencë të saj.

35.3 Organi Qendror Fiskal konsultohet me BPK-në në rastet e përgatitjes së buxhetit.

Neni 36

Depozitat dhe arka

BPK-ja mund të pronojë depozita në çfarëdo valute nga Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, nga Organi Qendror Fiskal dhe nga subjektet e tjera të saj. Si depozitar, BPK-ja pranon dhe jep para, mban llogari për to dhe ofron shërbime financiare lidhur me to. BPK-ja paguan në kufijtë e shumave të depozituara sipas urdhërpagesave për llogaritë përkatëse. BPK-ja paguan kamatën për këto depozita sipas përqindjes së tregut, pas zbritjes së provizioneve të arsyeshme.

Neni 37

Funksioni i agjencisë fiskale

BPK-ja, në përputhje me kriteret dhe kushtet për të cilat mirret vesh me Organin Fiskal Qendror, mund të veprojë si agjent fiskal për llogari të Organit Qendror Fiskal, agjentëve të tij dhe instrumenteve të cilat mund t'i përcaktojë Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Neni 38
Informatat që duhet t'i jepen BPK-së

Nga Organi Qendror Fiskal dhe nga subjektet e tjera të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, BPK-ja i merr të gjitha të dhënat financiare dhe ekonomike dhe dokumentet që ajo i kërkon prej tyre për ushtrimin e detyrave të saj.

**RAPORTET ME INSTITUCIONET FINANCIARE DHE FUNKSIONIMI
I SISTEMIT TË PAGESAVE**

Neni 39
Pagesat, likuidimi dhe shlyerja

BPK-ja mund të organizojë, posedojë, operojë, mbikëqyrë dhe rregullojë sistemet e urdhërpagesave dhe shlyerjen e pagesave ndërbankare në valutat e caktuara, qofshin ato mjete legale për pagesa apo jo, duke përfshirë pagesat me anë të çekut dhe me anë të instrumenteve të tjera të pagesës, përcakton procedura dhe nxjerrë rregulla e urdhëresa që çmohen të përshtatshme lidhur me to.

Neni 40
Llogaritë e bankave të BPK-ja

Çdo bankë që vepron në Kosovë e që dëshiron të kryejë pagesa, me sistemin dhe shlyerjen e detyrimeve duhet të hapë dhe të mbajë një llogari në librat e BPK-së sipas kushteve të caktuara nga BPK-ja dhe duhet t'i jep menjëherë BPK-së informacionin e kërkuar lidhur me kushtet financiare të përcaktuara me rregullore të BPK-së.

Neni 41
Rrjeti informativ

BPK-ja mund të themelojë dhe mirëmbajë një rrjet informativ për sistemin financiar të Kosovës.

Neni 42
Mbikëqyrja dhe rregullimi i institucioneve financiare

BPK-ja është i vetmi organ përgjegjës për licencimin e institucioneve financiare në Kosovë dhe për mbikëqyrjen e rregullimin e tyre dhe është e autorizuar:

(a) Të nxjerrë rregullore, urdhëra dhe udhëzime dhe të ndërmarrë veprime të tjera, duke përfshirë revokimin e licencave të institucioneve financiare dhe marrjen nën kontroll të institucioneve të pasuksesshme financiare për të cilat konsiderohet e nevojshme ose e këshillueshme për kryerjen e kompetencave dhe përgjegjësive që dalin nga kjo Rregullore dhe ligjet tjera në fuqi;

(b) Të iniciojë kontrollin që duhet ta kryejë një nëpunës i saj apo ndonjë person tjetër i kualifikuar, i caktuar nga institucioni financiar për këto qëllime dhe t'i kontrollojë librat, shënimet, dokumentet dhe llogaritë e saj për të konstatuar kushtet e veprimtarisë së saj dhe se a vepron në përputhje me këto rregullore, me rregullat, urdhërat dhe ligjet në fuqi për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare;

(c) Të kërkojë nga drejtori, zyrtari apo nëpunësi i një institucioni financiar t'i japë BPK-së informatat e kërkuara me qëllim që t'i mundësohet BPK-së mbikëqyrja dhe rregullimi i institucioneve financiare dhe

(ç) Të detyrojë ndonjë bankë të ndërmarrë veprime përmirësuese ose të ngrisë padi sipas kësaj Rregulloreje ose ligjit në fuqi për licencimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare, nëse nga një institucion financiar ose nga një ose më shumë zyrtarë apo drejtorë të tij ka pasur shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe të ligjit në fuqi a të direktivës së BPK-së, ose është shkelur ndonjë kusht apo kufizim i bashkëngjitur ndonjë autorizimi a miratimi të nxjerrë nga BPK-ja, ose shkelje të çfarëdo rregulli a urdhëri të nxjerrë nga BPK-ja.

Neni 43

Rregullat e kursimit

43.1 Çdo institucion financiar duhet të veprojë në përputhje me rregullat dhe urdhëresat e parapara të BPK-së përkitazi me: fletbilancin e llogarisë, angazhimet jashtë bilancit dhe dëftesat e të ardhurave, shpenzimet lidhur me përpjesëtimin ndërmjet llogarive apo faturave dhe ndalimeve, kufizimeve apo kushteve për lloje a forma specifike të kredive ose të investimeve të kredive a të investimeve që tejkalojnë shumën e caktuar apo format e detyrimeve me rrezikshmëri sa i përket përmbushjes së afatit të aktivitetit dhe pasivitetit dhe zërave të pabalancuar të bilancit apo valutave konvertibile, këmbimeve, të drejtës së blerjes, çështjeve të tjera të ngjashme dhe çështjet e sistemit të pagesave.

43.2 Institucionet financiare që angazhohen në punë të njëjta dhe që janë në gjendje të mirë financiare duhet gjithashtu t'u përmbahen këtyre rregullave dhe urdhëresave.

Neni 44
Dërgimi i informatave në BPK

44.1 Institucionet financiare duhet ta informojnë BPK-në për aktivitetin dhe gjendjen financiare të tyre, ndonëse BPK-ja mund t'i kërkojë këto informata.

44.2 BPK-ja mund të publikojë informata dhe të dhëna të tjera të plota ose të pjesërishme për llojet e institucioneve financiare të ndara sipas natyrës së punës së tyre.

RREGULLIMI DHE FUNKSIONIMI I KËMBIMIT TË VALUTAVE

Neni 45
Dilerët e këmbimit të valutave

BPK-ja është e autorizuar:

(a) Të nxjerrë rregulla dhe urdhëresa për administrimin e transaksioneve të këmbimit valutor për individë, ndërmarrje jofinanciare, institucione financiare, agjenci dhe mekanizma të themeluara sipas ligjit në fuqi në Kosovë;

(b) Të mbikëqyrë dhe të rregullojë punën e dilerëve të këmbimit të valutave, duke përfshirë këtu edhe bankat;

(c) Të përcaktojë kufijtë e pozicioneve të këmbimit të valutave për dilerët, duke përfshirë këtu edhe bankat dhe

(ç) Të themelojë metodën për caktimin e vlerës së valutave ndaj valutave të tjera.

Neni 46
Raportimi mbi transaksionet devizore

BPK-ja mund të kërkojë nga dilerët e licencuar të këmbimit të valutave të huaja, duke përfshirë këtu edhe bankat, të raportojnë periodikisht për punën e tyre, duke përfshirë pozicionet e tyre të hapura valutore për çdo valutë; BPK-ja i përcakton formularët për raportim dhe dokumentet tjera përcjellëse që duhet të dorëzohen.

Neni 47
Afarizmi në këmbimin e valutave

BPK-ja bën:

- (a) Blerjen, shitjen, manipulimin me monedha të arit, me shufra ari ose me metale të tjera të çmueshme;
- (b) Blerjen, shitjen ose merret me këmbimin e valutave të huaja, duke përdorur për këto qëllime aktivat e përshkruara në nenin 48 dhe
- (c) Përcaktimin e çmimit të blerjes, të shitjes ose të manipulimit me valutat e huaja.

Neni 48
Mjetet valutore

48.1 BPK-ja mban në bilancin e saj dhe administron aktivet në valutë të huaj që përbëhen nga një ose nga të gjithë aktivat vijuese:

- (a) Ari;
- (b) Valuta e huaj në banknota dhe në monedha që mbahen në Kosovë apo në llogaritë bankave që mbahen jashtë vendit në valutë të huaj, pasivet afatshkurta të cilat klasifikohen në një nga dy kategoritë më të larta të agjencive të klasifikimit të kredive të njohura ndërkombëtare dhe
- (c) Letrat me vlerë të emetuara apo të garantuara nga shtetet ose bankat e Bashkësisë Evropiane me skadimin e afatit prej 180 ditësh të denominuara dhe të pagueshme në euro.

48.2 Qëllimet kryesore në zgjedhjen e aktivave në valutë të huaj janë siguria e kapitalit dhe likuiditeti. Varësisht nga këto qëllime, këto aktive zgjedhen për t'i rritur fitimet.

Neni 49
Marrëveshjet e kliringut dhe të pagesave

BPK-ja, për llogari të veten ose për llogari dhe me urdhrin e Organit Qendror Fiskal mund të hyjë marrëveshje kliringu dhe të pagesave ose në ndonjë kontratë tjetër për të njëjtin qëllim me institucionet qendrore të kliringut publik dhe privat, në vend apo jashtë.

ADMINISTRIMI ME VALUTË

Neni 50 Ruajtja e valutave

BPK-ja iu siguron, pas pagimit të taksave të arsyeshme, lokale institucioneve financiare dhe publike për ruajtjen e banknotave dhe monedhave në valuta të cilat ajo i cakton.

Neni 51 Rezervat në valutë

BPK-ja administron një inventar të valutave rezervë që ajo i konsideron të përshtatshme për pagimin e transaksioneve në vend dhe jashtë, për të siguruar furnizim të rregullt për përmbushjen e nevojave të ekonomisë së Kosovës, duke caktuar dhe duke marrë provizion të arsyeshëm për shërbimet e tilla.

GJENDJA FINANCIARE, REVIZIONI DHE RAPORTET

Neni 52 Viti financiar i BPK-së

Viti financiar i BPK-së fillon me ditën e parë të janarit dhe mbaron me ditën e fundit të dhjetorit.

Neni 53 Zbatimi i kontabilitetit

53.1 BPK-ja mban llogari dhe shënime për veprimet dhe gjendjen financiare në përputhje me standardet ndërkombtare të kontabilitetit.

53.2 Pasqyrat financiare të BPK-së përfshijnë llogaritë e veçanta të rezervës së përgjithshme, fondet për mbulimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta dhe zhvlerësimin në pasuri efektive.

Neni 54 Dëftesat financiare

BPK-ja përgatit pasqyrat financiare për çdo vit financiar. Ato përfshijnë bilancin, pasqyrzën e fitimit dhe të humbjeve dhe pasqyrëza të tjera të ngjashme me to.

Neni 55
Revizioni i pavarur i llogarive të BPK-së

Llogaritë, shënimet dhe pasqyrat financiare të BPK-së do të kontrollohen nga revizorët e pavarur, ndërkomtarisht të njohur, të rekomanduar nga Këshilli drejtues dhe të miratuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i cili, për shkaqe të forta, mund t'i shkarkojë këta revizorë nga vendi i tyre i punës.

Neni 56
Përcjellja dhe publikimi i pasqyrave dhe i raporteve

56.1 BPK-ja brenda katër muajve pas mbylljes së çdo viti financiar ia dorëzon pasqyrzën dhe raportet Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm:

- (a) Bilancin financiar të verifikuar nga revizorët e tij të jashtëm;
- (b) Raportin për punën dhe afarizmin e tij gjatë atij viti dhe
- (c) Raportin për gjendjen ekonomike.

56.2 BPK-ja përgatit sa më shpejt që të jetë e mundur e më së largu brenda 15 ditësh pas ditës së fundit të punës të çdo tremujori një rezyme të bilancit financiar të tremujorit të fundit.

56.3 Pas kompletimit të tyre, BPK-ja e publikon bilancin financiar dhe raportet e përshkuara në nenet 56.1 dhe 56.2 dhe BPK-ja mund të publikojë raporte e studime të tjera për çështjet financiare dhe ekonomike nëse e sheh të arsyeshme.

DISPOZITAT E NDRYSHME

Neni 57
Konsultimet për propozimet mandatore

Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Kososvë e konsulton BPK-në për çdo propozim lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me objektivat e BPK-së, të cilat përndryshe, janë në kompetenca të saj para se propozimet të marrin formë të prerë.

Neni 58

E drejta e përparësisë e BPK-së

58.1 BPK-ja gëzon të drejtën e përparësisë së pakushtëzuar për përmbushjen e të gjitha kërkesave të saj nga çdo llogari në kesh dhe aktivave të tjera që ajo i mbanë për llogarinë e saj apo për llogarinë e huamarrësit, qoftë si mall i dhënë peng për sigurimin e kërkesave të saj, qoftë në kohën kur kërkesat e tilla bëhen të arritshme për pagesë.

58.2 BPK-ja e ka të drejtën e prioritetit të pakushtëzuar që t'i shlyejë borxhet e kërkuara në kesh nga çdo bilanc dhe në pasuri të mjeteve të tjera që ajo i mban për llogarinë e saj apo për llogarinë e huamarrësit qoftë paralelisht për t'i mbrojtur kërkesat e saj, apo përndryshe në kohën kur kërkesat e tilla të arrijnë për pagesë.

58.3 BPK-ja mund ta ushtrojë të drejtën e përparësisë vetëm duke mbajtur balancet në para të gatshme dhe duke shitur pasurinë tjetër me një çmim të arsyeshëm si dhe duke paguar veten nga të ardhurat, nga të ardhurat e shitjes dhe pas zbritjes së shpenzimeve që lidhen me atë shitje. Asnjë veprim gjyqësor nuk mund të kërkohet dhe asnjë kërkesë konkurruese nuk lejohet për të shtyrë ushtrimin e të drejtës së përparësisë së BPK-së në përputhje me dispozitat e këtij neni, e as kërkesat e pronësisë ose të drejtat e fituara më parë përderisa të mos ketë prova të qarta dhe bindëse që punëtorët e BPK-së e kanë ditur ose është dashur ta dinin se në kohën e vënies së pasurisë në pronësi të BPK-së, ajo nuk i ka takuar huamarrësit në fjalë.

Neni 59

Veprimtaritë e ndaluara për BPK-në

59.1 Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me këtë Rregullore ose me rregullore tjetër apo me ndonjë urdhëresë administrative tjetër, BPK-ja:

(a) Nuk jep kredi, nuk mban depozita dhe nuk jep dhurata në parra ose dhurata të tjera financiare;

(b) Nuk angazhohet në tregti me blerjen e aksioneve të ndonjë korporate apo ndërmarrjeje duke përfshirë edhe aksionet e ndonjë institucioni financiar, ose të ketë interes të pronësisë në çfarëdo pune financiare, tregtare, bujqësore, industriale e të tjera dhe

(c) Nuk fiton nga blerja, qiraja ose e drejta në pasuri të paluajtshme, përveç kur ajo e sheh të nevojshme apo të dobishme sigurimin e zyreve për udhëheqjen e punëve administrative apo për sigurimin e objekteve banesore

për puntorët e saj ose kërkesa të tjera të ngjajshme për nxjerrjen e funksioneve të saj të përcaktuara me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

59.2 Pavarësisht nga dispozitat tjera të kësaj Rregulloreje, BPK-ja mund:

(a) Të jep hua, të zotërojë aksione, të jetë pjesëmarrëse në ndonjë organizatë që është e angazhuar në aktivitetet që kërkohen për kryerjen si duhet të funksioneve ose përgjegjësi të BPK-së;

(b) Të përfitojë me qëllim të përmbushjes së kërkesave të saj çfarëdo kamate ose të drejte nga neni 59.1(b) me kusht që të gjitha këto kamata ose të drejta të jepen në rastin më të parë të mundshëm dhe

(c) T'u jep kredi punëtorëve të vet për qëllime, në shuma, afate dhe kushte të përcaktuara prej saj me kusht që shumat e këtyre kredive të hiqen nga llogaritë kapitale.

Neni 60

Grumbullimi i informatave statistikore

60.1 BPK-ja grumbullon informata statistikore të nevojshme për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e detyrave të saj dhe për këtë qëllim mund të angazhohet në bashkëpunim teknik me autoritetet kompetente jashtë Kosovës.

60.2 BPK-ja përcakton informatat statistikore të nevojshme dhe mënyrën sipas të cilës këto informata i dërgohen BPK-së, personat që duhet t'i sjellin këto informata në BPK dhe procedurën për ruajtjen e fshehtësisë që zbatohet për informatat statistikore e të dhënat e BPK-së.

60.3 BPK-ja kontribuon në harmonizimin e rregullave dhe praktikave për administrimin e grumbullimit, përpunim dhe shpërndarjes së informative statistikore brenda kompetencave të saj.

Neni 61

Përfundimi i BPK-së nga tatimet

Aktivat, prona dhe të ardhurat e BPK-së, operacionet dhe transaksionet e saj përfundohen nga pagimi i të gjitha tatimeve dhe i detyrimeve mbi të ardhurat, pasuritë, akcizat dhe tatimi mbi fitimin.

Neni 62

Kompetencat rregullatore dhe të inspektimit të BPK-së

62.1 BPK-ja ka kompetenca të nxjerrë rregulla, urdhra ose udhëzime, të vizitojë bankat, të kontrollojë llogaritë, librat, dokumentet dhe të dhënat e tjera, të ndërmarrë aksione të tjera të cilat i gjykon të nevojshme ose të arsyeshme për të zbatuar dispozitat e kësaj Rregulloreje.

62.2 Të gjitha rregullat, urdhëresat dhe udhëzimet të nxjerra nga BPK-ja, që vlejné për më shumë se një institucion financiar publikohen dhe hyjnë në fuqi në ditën e botimit ose në një datë të mëvonshme që përcaktohet në vetë direktivën, urdhëresën ose udhëzimin. BPK-ja mban një regjistër publik për këto rregulla, direktiva, urdhëresa dhe udhëzime.

62.3 Rregullat dhe urdhëresat e BPK-së janë vendime përfundimtare në procedurën administrative.

Neni 63

Standardet e administrimit të mirë

63.1 BPK-ja në përputhje me praktikat e shëndosha administrative zbaton kompetencat e saj të përcaktuara me këtë Rregullore në mënyrë të barabartë dhe uniforme. Ajo nuk do t'i zbatojë këto kompetencës në shërbim të ndonjë objekti, të parashikuar me to ose që i tejkalon këto kompetenca.

63.2 Vendimet e BPK-së të marra në përputhje me këtë Rregullore janë të paanshme dhe të motivuara vetëm nga konsiderata objektive dhe racionale; këto vendime zbatohen me ndershmëri dhe maturi.

Neni 64

Llogaritë truste

BPK-ja autorizohet të hapë dhe të mbajë në librat e saj llogaritë, aktivat dhe pasivat e të cilave do të veçohen nga aktivat dhe pasivat e tjera të BPK-së. Aktivat e çdo llogarie të tillë shërbejnë vetëm për plotësimin e pasivave të asaj llogarie dhe asnjë aktivë tjetër i BPK-së nuk shërben për plotësimin e pasivave të kësaj llogarie.

Neni 65

Politika e punësimit

BPK-ja zbaton politikë jodiskriminuese gjatë punësimit në mënyrë që përbërja e të punësuarve të pasqyrojë natyrën shumetnike të bashkësive në Kosovë.

Neni 66

Shqyrtimet juridike

Në çfarëdo procedure gjyqësore ose të arbitrazhit që ndiqet në lidhje me këtë Rregullore kundër BPK-së ose ndonjë zyrtari, të punësuari a agjenti të BPK-së:

(a) pyetja e vetme para gjyqit ose gjyqit të arbitrazhit në përcaktimin se a ka vepruar i padituri kundër ligjit, është nëse i padituri ka vepruar në mënyrë arbitrare apo kapricioze duke ditur faktet, ligjin ose rregullat a urdhëresat dhe udhëzimet e nxjerra;

(b) udhëheqësi, i punësuari apo agjenti i BPK-së nuk është përgjegjës për dëmet, veprimet ose mosveprimet e bëra gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësi të tij, përveç kur këto veprime dhe mosveprime përbëjnë qëndrim të gabuar me dashje dhe

(c) veprimi në fjalë do të vazhdojë pa kufizime gjatë kohës së një ankimi dhe çdo ankimi të mëtutjeshëm apo procedurave të tjera në lidhje me ankimin.

Neni 67 Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 68 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çfarëdo dispozite të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 69 Dizpozitat kalimtare

69. 1 Pavarësisht nga neni 11 dhe 12, dy vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ose më herët, kur BPK-ja vërteton se bankat në Kosovë mund të veprojnë, BPK-ja mund të hapë llogari depozitare në librat e saj në emër të personave fizikë dhe të ndërmarrjeve, në valuta të përcaktuara prej saj me apo pa tender ligjor, të pranojë dhe të paguajë para dhe të mbajë llogari për to dhe të kryejë shërbimet e pagesave e të arkëtimit për to. BPK-ja paguan, në lartësi të shumës së depozituar, sipas urdhërpagesave lidhur me këto llogari. BPK-ja nuk paguan kamatë për këto deponime. Llogaritë e tilla do t'i nënshtrohen kritereve

dhe kushteve të përcaktuara nga BPK-ja, duke përfshirë këtu edhe pagesën e shpenzimeve të arsyeshme. Llogaritë e tilla nuk merren parasysh për përcaktimin e shumës së kapitalit dhe të llogarisë së rezervës së përgjithshme lidhur me shumën e bilancit të kredisë të të gjitha llogarive që mbahen në librat e BPK-së nga mbajtësit e llogarive të paraqitura në bilancin përfundimtar të BPK-së në fund të çdo viti financiar.

69. 2 Tridhjetë ditë pas ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, asnjë subjekt nuk mund të ushtrojë veprimtari bankare në Kosovë pa paraqitur një kërkesës për licencim te BPK-ja në përputhje me këtë Rregullore.

69. 3 Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, organet që kryejnë transaksionet e pagesave dhe punët e bankës qendrore në Kosovë do ta ndërpresin aktivitetin e tyre nëse sipas mendimit të BPK-së do të konsiderohet se kjo është ndërhyrje në funksionet e saj.

69. 4 Për shpërblimin e marrë apo heqjen dorë nga këto shpërblime nga anëtarët e Këshillit drejtues për shërbimet e tyre në BPK-ë, përveç shpërblimit nga neni 19 i kësaj Rregulloreje, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm duhet të njoftohet me shkrim.

Neni 70
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore¹, e ndryshuar, hyn në fuqi më 1 tetor të vitit 2001.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

¹ Rregullorja e parë ka hyrë në fuqi më 15 nëntor të vitit 1999